



culture 21

Agenda 21 for culture
Agenda 21 de la culture
Agenda 21 de la cultura

**Qytetet dhe qeveritë lokale të bashkuara
- Komiteti për kulturë**

**Këshilla mbi zbatimin lokal
të Agjendës 21 për kulturë**



**Ajuntament de Barcelona
Institut de Cultura**



**United Cities and Local Governments
Cités et Gouvernements Locaux Unis
Ciudades y Gobiernos Locales Unidos**

Këshilla mbi zbatimin lokal të Agjendës 21 për kulturë

Dokumenti i miratuar më 24 tetor, 2006 në Barcelonë,
në mbledhjen e parë të Komitetit për kulturë të QQLB

1. Hyrje

Agjenda 21 për kulturë është miratuar nga qytetet dhe qeveritë lokale anembanë botës më 8 maj, 2004, si dokument udhëzues për politikën kulturore publike dhe si kontribut në zhvillimin kulturor të njerëzimit.

Qytetet dhe Qeveritë Lokale të Bashkuara (QQLB) e miratuan Agjendën 21 për kulturë si dokument referencë për programet e saj për kulturë duke pretenduar rolin e koordinatorit të procesit si rrjedhojë e miratimit të saj. Komiteti i QQLB-së për kulturë është pikëtakim për qytetet, qeveritë dhe rrjetet lokale që e vendosin kulturën në thelb të proceseve të tyre zhvilluese.

Një numër në rritje i qyteteve dhe qeverive lokale anembanë botës formalisht e kanë miratuar Agjendën 21 për kulturë. Dokumenti i miratuar standard gjendet në uebfaqet **www.agenda21culture.net** dhe **www.cities-localgovernments.org**. Miratimi i Agjendës 21 për kulturë ka rëndësi të madhe simbolike: e shprehë vendosmërinë e qytetit për ta bërë kulturën çështje kyçe të politikave urbane dhe është shenjë e solidaritetit dhe bashkëpunimit me qytetet dhe qeveritë lokale anembanë botës.

Qytetet e përdorin Agjendën 21 për kulturë, në njërin anë, për të avokuar në qeveritë nacionale dhe organizatat ndërkombëtare mbi rëndësinë e kulturës në zhvillimin lokal dhe në anën tjetër, për t'i fuqizuar politikën kulturore lokale.

Më 2006, me kërkesë të disa qyteteve, Komiteti i QQLB-së për kulturë ka bërë disa rekomandime të përgjithshme që mund të jenë të dobishme për zbatimin lokal të Agjendës 21 për kulturë.

2. Kultura si shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm

Planifikimi kulturor

Marrëdhënia në mes të kulturës dhe zhvillimit të qëndrueshëm po fuqizohet si parim themelor i politikave lokale. Agjenda 21 për kulturë, si dokument udhëzues për politikën kulturore publike, ofron mundësi që secili qytet të krijojë vizion afatgjatë të kulturës si shtyllë në zhvillimin e tyre.

Zbatimi lokal i Agjendës 21 për kulturë mund të shihet si ushtrim i planifikimit kulturor. Planifikimi kuptohet si proces i cili ka të bëjë me agjentët, objektivat, aktivitetet, resurset dhe rezultatet e pritura nga një projekt.

Planifikimi kulturor është përhapur në 10-15 vitet e fundit. Është përdorur për t'i zhvilluar politikat kulturore lokale të bazuara në vlerat (kujtesa, kreativiteti, dituria kritike, diversiteti, ritualet...) të cilat kultura ua sjellë individëve dhe komuniteteve. Gjithashtu, është përdorur për ta theksuar rëndësinë e kulturës në politikat tjera lokale, si punësimi dhe përfshirja sociale dhe për t'i prezantuar faktorët kulturorë në të gjitha politikat publike. Disa tekste kyçe e kanë përkrahur rëndësinë e planifikimit kulturor. Për shembull, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në Raportin për Zhvillimin Njerëzor 2004, "Liria kulturore në botën e sotme diverse", e thekson nevojën për të shkuar drejt kulturës së hapur si element thelbësor në të gjitha strategjitë zhvillimore. Një shembull tjetër është puna e hulumtuesit australian Jon Hawkes, i cili e propozon kulturën si shtyllën e katërt të qëndrueshmërisë, në të njëjtën radhë me tri shtyllat klasike: atë ekonomike, sociale dhe të ambientit.

Agjenda 21 për kulturë ofron një mundësi që çdo qytet të krijojë vizion afatgjatë për kulturën si shtyllë kryesore në zhvillimin e tyre. Sipas parimeve, vendimeve dhe rekomandimeve të Agjendës 21 për kulturë dhe duke i pasur parasysh karakteristikat lokale (historinë, popullatën, madhësinë, llojin e qeverisjes, vitalitetin e shoqërisë civile, identitetin dhe karakteristikat e sektorëve kulturorë...), çdo qytet apo qeveri lokale inkurajohet të marrë parasysh apo të konsideroj vlerën e çështjeve të ngritura në paragrafët në vijim të proceseve të tyre politik bërjes.

3. Konsideratat e përgjithshme

Paragrafët në vijim i paraqesin konceptet dhe konsideratat e përgjithshme në zbatimin lokal të Agjendës 21 për kulturë, që buron nga parimet, vendimet dhe rekomandimet e saj:

- a) Udhëheqja politike në nivelin më të lartë të qeverisjes lokale.
- b) Marrja përsipër e mjeteve nga qeveria lokale si tërësi, jo vetëm nga shërbimet, fushat dhe/apo departamentet përgjegjëse për kulturë.
- c) Qeveria lokale si katalizator i proceseve kulturore: fuqizimi i shoqërisë civile, mirëmbajtja e konsensusit dhe ndërtimi i përgjegjësive të përbashkëta.
- ç) Inkurajimi dhe stimulimi i pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve në formulimin, ushtrimin dhe vlerësimin e politikave publike mbi kulturën.
- d) Transparenca e informatave dhe komunikimi me qytetarë përmes kanaleve të ndryshme.

-
- dh) Saktësia teknike dhe argumentimi i qartë, duke përdorur ekspertë në hulumtimin dhe zhvillimin e politikave kulturore si dhe menaxhimin e kulturës.
- e) Njohja e nevojave dhe kërkesave të ndryshme kulturore të bëra nga njerëzit dhe organizatat e një territori, duke përfshirë aty edhe agjentët kulturorë edhe pjesën tjetër të qytetarisë.
- ë) Resurset kulturore të një territori përfshijnë sektorët 'klasikë' (trashëgimia, artet, bibliotekat) si dhe ato që gjenden në industritë kreative, mediat, arsim dhe sport.
- f) Fuqizimi i kohezionit të sektorëve kulturorë për nga mjetet e objektivave dhe veprimeve që sjellin vëmendje për vlerat e brendshme kulturore.
- g) Fuqizimi i kulturës si sferë publike bazuar në lirinë e të shprehurit, diturinë kritike, diversitetin, pjesëmarrjen dhe kreativitetin. Kjo sferë mirëmbahet nga agjentët dhe profesionistët në kulturë si dhe nga të shprehurit e kulturës nga qytetaria.
- gj) Koordinimi në mes të procesit të planifikimit kulturor dhe planeve strategjike të qytetit apo të çfarëdo procesi tjetër të integruar lokal (si Agjenda 21, Marrëveshja e Zonës Lokale, Planifikimi i Zonave Lokale të Integruara...).
- h) Zbatueshmëria ndër-sektoriale, duke sjellë perspektivë kulturore në projektin urban si tërësi, me objektiva dhe veprime që tregojnë si ndikon kultura dhe si ndikohet në kulturë, aktivitete në fushat si arsimi, shëndetësia, planifikimi urban dhe ekonomia.
- i) Krijimi i programeve për inovacion, laborator ose njësi specifike për zhvillimin e projekteve kyçe.
- j) Krijimi i procedurave të aplikimit dhe monitorimit për vendimet e marra.
- k) Krijimi i sistemit të indikatorëve kulturorë.
- l) Shqyrtimi i nevojave për trajnime në politikat/menaxhimin/ndërmjetësimin e kulturës, që buron nga rëndësia e kulturës në shoqëri.
- ll) Marrëdhënia e proceseve kulturore me administratat publike rajonale, nacionale dhe ndërkombëtare, për t'i kontekstualizuar prioritetet dhe për të orientuar sigurimin e resurseve ekonomike.
- m) Pjesëmarrja e qytetit në rrjete dhe asociacione multilaterale që i dedikohen bashkëpunimit kulturor, shkëmbimit të praktikave të mira dhe avokimit për rëndësinë e kulturës në programet nacionale dhe ndërkombëtare.

4. Mjetet

Nëse dëshirohet që këto konsiderata të përgjithshme të ndikojnë në jetën e qytetit, është e domosdoshme të zhvillohen mjete specifike. Këto mund të përfshijnë një dokument, këshill dhe/apo iniciativa tjera. Çdo qytet apo qeveri lokale do ta gjejë formulën që më së miri u përshtatet nevojave të tyre. Katër mjetet në vijim sugjerohen si shembuj.

4.1. STRATEGJIA KULTURORE LOKALE

Zhvillimi i strategjisë kulturore lokale përfshinë debatin, nxjerrjen dhe miratimin e një dokumenti i cili i përshkruan prioritetet kulturore të një qyteti. Procesi më efektiv do të ishte ai që i angazhon të gjithë agjentët kulturorë në territor bashkë me qytetarinë dhe administratën publike. Procesi zakonisht fillon me një auditim dhe vlerësim të resurseve kulturore të një qyteti, të trendeve ekonomike, sociale dhe territoriale. Strategjia kulturore atëherë mund të formësohet në dokument, të debatuar dhe miratuar nga plenaret komunale ose nga autoritetet si këshillat apo komisionet me pjesëmarrje të qytetarisë. Dokumenti normalisht përbëhet nga deklarata e misionit, objektivat e ndryshme dhe disa veprime apo aksione. Dokumenti i vendosë përgjegjësitë e përbashkëta në mes të qeverisë lokale, agjentëve kulturorë dhe shoqërisë civile. Strategjia kulturore normalisht e përfshinë një orar të zbatimit, indikatorë për përcjellje dhe vlerësim për secilën objektive dhe veprim si dhe procedurat e monitorimit.

4.2. KARTA E TË DREJTAVE DHE PËRGJEGJËSIVE KULTURORE

Karta lokale e të drejtave kulturore është dokument që në mënyrë specifike i definon të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të një territori. Një dokument i tillë do të duhej ta kishte bazën në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në dokumente tjera të njohura ndërkombëtare që i mbulojnë të drejtat e njeriut dhe kulturën. Zhvillimi efektiv i kartës lokale i të drejtave kulturore mbështetet në pjesëmarrjen aktive të agjentëve kulturorë të territorit, qytetari, administratë dhe ekspertë të të drejtave të njeriut. Dokumenti normalisht do të duhej të miratohej nga plenaret komunale dhe do të përfshinte krijimin e një personi apo organizate për ta garantuar përmbushjen e Kartës dhe që të bëhej ndërmjetës në situata komplekse që kanë të bëjnë më të drejtat dhe përgjegjësitë kulturore.

4.3. KËSHILLI KULTUROR

Këshilli kulturor është trup publik që i adreson çështjet kulturore të një qyteti. Një këshill i tillë normalisht do ta reflektonte diversitetin e agjentëve kulturorë : sektorët e ndryshëm (trashëgimia, artet, bibliotekat...), dimensionet e ndryshme (nga agjentët e mëdhenj deri të iniciativat e vogla), strukturat e ndryshme (publike, private, shoqërore...) dhe ndryshore tjera. Normalisht, këshilli do të duhej të debatonte dhe të nxirrte opinione mbi temat më të rëndësishme kulturore në qytet. Autoriteti i këshillave të tillë është i ndryshëm: ka këshilla që janë vetëm këshillëdhënës deri te ata këshilla që kanë kapacitet për të marrë vendime ekzekutive.

4.4. VLERËSIMI I NDIKIMIT KULTUROR

Projektet e zhvillimit lokal shpesh i vlerësojnë ndikimet ekonomike, sociale dhe ambientale po rrallë analizohen ato kulturore. Agjenda 21 për kulturë, në artikullin 25, e promovon zbatimin e formave të “vlerësimit të ndikimit kulturor” të iniciativave “që përfshijnë ndryshime të rëndësishme në jetën kulturore të qyteteve”. Vlerësimi i ndikimit kulturor është dokument që zhvillohet në konsultim me qytetarinë dhe agjentët kulturorë, që i analizon kontributet (pozitive dhe negative) që një zhvillim lokal mund t'i prodhojë në jetën kulturore të një qyteti. Duke pasur parasysh ndikimin që mund ta kenë të gjitha projektet në jetën kulturore, ka shumë gjasë që “vlerësimi i ndikimit kulturor” mund të konsiderohet si proces që mund të aplikohet në bërjen e të gjitha politikave dhe programeve.

**United Cities and Local Governments
Cités et Gouvernements Locaux Unis
Ciudades y Gobiernos Locales Unidos**

carrer Avinyó, 15
E-08002 Barcelona
Espanya

Tel: +34 93 342 87 50
Fax: +34 93 342 87 60
info@cities-localgovernments.org
www.cities-localgovernments.org

**Ajuntament de Barcelona -
Institut de Cultura**

Palau de la Virreina - la Rambla 99
E-08002 Barcelona
Espanya

Tel: +34 933 161 000
Fax: +34 933 161 020
agenda21cultura@bcn.cat
www.bcn.cat/cultura

www.agenda21culture.net



**United Cities and Local Governments
Cités et Gouvernements Locaux Unis
Ciudades y Gobiernos Locales Unidos**



**Ajuntament de Barcelona
Institut de Cultura**